



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 25 Prot.

Tiranë, më 04.01.2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 1 datë 04.01 2023

MIRATIMIN E PAGESËS PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË
MENJËHERSHME
PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS TË PUNONJËSVE
TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS.

Në zbatim të nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH" të VKM nr 898 datë 29.12.2022" për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësvedhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik , për zbutjen e impaktit të krizës" në Vendimin e Senatit nr.1 datë 04.01.2023 Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues

VENDOSI:

- 1.Të paguhen si mbështetje financiare e menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës në vlerën 20 000 lekë të gjithë punonjësit të punësuar, në vitin 2022, në Universitetin të Sporteve të Tiranës, që paguhen me pagë bruto nën 60 000 lekë. Numri i punonjësve që përfitojnë janë 12.
- 2.Të paguhen si mbështetje financiare e menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës në vlerën 10 000 lekë të gjithë punonjësit të punësuar, në vitin 2022, në Universitetin e Sporteve të Tiranës që paguhen me pagë mbi 60 000 lekë. Numri i punonjësve që përfitojnë janë 154.
- 3.Efekti financiar është në vlerën prej 1 780 000 lekë, i cili mbulohet nga fonde të buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës të vitit 2022.
- 4.Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

PI Artur Çobani

Artur Çobani

Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Tel: 35542226652, eëë.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

